

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**SHOQERIA "NPA" SHPK**

**STATUTI DHE AKT**  
**THEMELIMI**

**Tirane 04.03.2023**

# **STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE NPA SHPK**

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", ne ligjin Nr.9001 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin tone te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt- themelimi dhe statuti te shoqerise.

## **KREU I**

### **THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA**

#### **Neni 1 Data e Themelimil, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me 04.03.2023 ne, themeluesit;

- 1.Pjetër Berhani, i biri i Markut, lindur më 29.05.1969 në Krujë, dhe banues ,Ruga Bektash Berberi pranë fshatit Sos Banesa Nr.1 Njësia Bashkiake Nr.2 Tiranë , paisur me numër personal G90529045N .
- 2.Roni Çupi i biri i Njaziut lindur me 10.05.2004 në Burrel dhe banues,Ruga Fadil Deliu Pallati Nr.3 Apartamenti 34 Njesia nr.12 Tiranë ,i paisur me numër personal K40510043Q ,kemi krijuar një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:
  - a)Shoqëria trgëtare me pernjegjësi te kufizuar është emërtuar **NPA Shpk**, e cila më poshtë do te quhet shoqëria.
  - b)Shoqeria ka vulen dhe logon e saj tregtare.

#### **Neni 2 Objekti**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin tregtar shqiptar do të jetë:

- Import-eksport tregtimit me shumicë dhe pakicë të materialeve e paisjeve elektrike,industriale e elektroshtëpiake,paisjeve e sistemeve /impianteve të kondicionimit si dhe impianteve të tjere të çfardo lloji.  
Pojktim dhe instalim i impianteve paisjeve elektrike, elektroshtëpiake, industriale, sistemeve te kondicionimit, si dhe impianteve të tjera të çfardolloji në vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre në objekte të ndryshme.
- Import-eksport dhe tregtësi me shumicë dhe pakicë të kabllove elektrik, alumin, bakër apo çdo lloj metali tjeter, sistemeve të sinjalizimeve elektrike, centraleve elektrike, hidraulike termike, impianteve për prodhimin e energjisë alternative, materiale ndricimi në ndertesa private dhe

ambiente publike, panele komandimi,software te ndryshem inverter apo softstware transformatorësh elektrike, elektromotorësh të ndryshëm, pompash zhytëse, sipërfaqësore apo pompa KUZ të fuqive të ndryshme .

- Import-eksport dhe tregëti me shumicë dhe pakicë të materialeve elektrike, hidraulike, rakorderive, çisternave të resinit apo të materialeve të ndryshme,hidrosanitare,materiale ndërtimi, mjete të kategorive të ndryshme,pjesë këmbimi për automjete,goma të ndryshme, bateria utomjetesh, tregtim të gazit të lëngshëm, vajrave lubrifikante për automjete dhe mjete të cdo lloji, grasove, kushinetave etj.
- Shitje-Blerje automjete dhe mjete të kategorive të ndryshme me goma dhe me zinxhir.
- Makina dhe mjete të tonazheve te ndryshem me qera per periudha afatshkurter,afatgjate si dhe veprimtari ne fushën e qerasë financiare dhe operacionale.
- Import-eksport dhe tregëti me shumice dhe pakicë të pijeve alkolike ,alkoolit, alkoolit etilik, materiale mjekësore,pajisje mjekësore të ndryshme, pajisje imazherie mjekësore të ndryshme.
- Import-eksport tregëtimit me shumicë dhe pakicë të makinerive të ndryshme industriale dhe bujqësore, veglave të punës të të gjitha llojeve,sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale me relief, bojrave për sinjalistikën rrugore horizontale, biçikletave të ndryshme mekanike dhe elektrike,matësave elektrikë dhe uji dhe vulave të sigurisë për matësa uji apo matësa elektrik dhe vula doganore, dhe cdo lloj matësi tjeter,tabak gome,llamarine,profile metali dhe duralumini, tubo dhe produkte metalike të ghitha dimensioneve,paisjeve dhe impianeve të ndryshme të karakterit publik,industrial,bujqësor,tregtar, kulturor,sportiv, të sherbimeve, të artikujve të ndryshëm industriale,bujqësore, produkteve ushqimore për njerëz dhe kafshë.
- Tregëtim karburantesh me pakicë,vajra lubrifikant gazi i lëngshëm për ngrohje dhe paisje ngrohje .
- Kryerja punimeve ndërtimore si ndërtimë civile ekonomike,ndërtimë rrugore,vepra arti të vogla , punime rikonstruksioni të godinave civile ekonomike,karpentierie,monitime dhe instalime elektrike në rrjetin e tensionit të lartë,tensionit të mesëm dhe të ulët punime hidraulike në rrjetin shpërndarës dhe të brendshëm,sisteme kondicionimi e aspirimi.
- Transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit për nevoja vetjake dhe të tretë.
- Sherbime kërkimi,projektimi,punime dhe konsulencë në fushën e ekonomisë, kontabilitetit dhe auditimit finansiarë e marketingut,telekomunikacionit,energiisë,programeve kompjuterike dhe internetit.
- Import-eksport dhe tregeti me shumice dhe pakice te artikujve kancelarik,tonerave, konsumablave për pajisje të ndryshme, lodrave për fëmijë, lodrave elektronike, lojërave elektronike dhe sistemet software të tyre, kompjuterave, printerë dhe pajisjese të tjera kompjuterike, software dhe hardware të ndryshëm, mobiljeve dhe orëndive druri, metali, duralumini,xhami për çdo ambient, pajisjeve të zyrave, mobilje të zyrave etj.
- Shërbime hotelerie dheturizmi bare kafe restorante .
- Investimi i kapitalit dhe i mjeteve te tjera financiare , per blerje te pasurive te lujtshme dhe te palujtshme dhe ne vazhdim te aktivitetit te saj, shitja e tyre per te arritur qellimet e shoqerise, si dhe cdo aktivitet tjeter qe vecas ose me ato te permendura me siper do te konsiderohen te pershtatshme dhe me leverdi per shoqerine dhe qe jane konforme legjislacionit ne fuqi.

**Neni 3**  
**Knhezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.

**Neni 4**  
**Selia e shoqerise,adresa e faqes se internetit dhe adresa elektronike.**

- a) Selia e shoqërisë ndodhet në **Njesinë Vlas, Bashkia Kamez "Rruga e Kukesit" zona kадestrale nr.2066, numër pasurie 43/238, qarku Tiranë.**
- b) Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakëve të shoqërisë.
- c) Shoqëria mund të hap apo të mbyllë filiale, dege dhe/ose zyre përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.
- d) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është [www.npa.al.com](http://www.npa.al.com)
- e) Adresa e shoqërisë për qellime të komunikimit elektronik është cel:06xxxxxxxxx dhe email; [npa.albania@yahoo.com](mailto:npa.albania@yahoo.com)

**KREU II**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali fillestare i shoqërisë është i ndarë në 2(dy) kuota me vlerë 3,000,000 lek(tre miljonë)lek.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë eshtë në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1.Ortaku themelues Pjetër Berhani,zotëruar i 1(një)kuotë me vlerë 1,500,000 lek (*Njëmiljon e pesëqind mijë*)lek që perben 50% kapitalit themeltare të shoqërisë.
- 1.Ortaku themelues Roni Çupi ,zotëruar i 1(një)kuotë me vlerë 1,500,000 lek (*Njëmiljon e pesëqind mijë*)lek që përbën 50% kapitalit themeltarë të shoqerisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me ane të kontributeve në natyre, nepermjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqerise.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njejtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që perfaqësojnë.

**Neni7**  
**Transferirni i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen neperrnjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoquerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendirmarres i shoquerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqueris qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoquerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoquerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe 'ç" te kesaj pike;
- dh)mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- t) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoquerise ne gjykate dhe procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoquerise;

- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asarnblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### Neni 9

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### Neni 10

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidher perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### Neni 11

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e per gjithshme vndos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelirnin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vndos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) cmerirnin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktirnin e shperblirneve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga adrninistratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise nc gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 12

#### Perjashtimi nga e drejta e votes

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### Neni 13

#### Administrimi

1.Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si adrninistratore te shoqerise.

2.Afat i emerirnit, eshte 5 vjet, me te drejte riparteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kornbetare te Regjistrimit.

3.Administratori(t) i/e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktirnit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si adrninistratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas.  
Cdo emerirn i bere ne kundershtirn me keto dispozita eshte i pavlefshem.

4.Si Administrator i pare i shoqerise me afat 5(pese)vjeçar duke filluar nga data 04.03.2023 deri me 03.03.2028 me te drejte rizgjedhje zgjidhet :

Zoti **Pjetër Berhani** lindur me 29.05.1969 me nr. Personal G90529045N, banues Rruga "Bektash Berberi" pranë fshatit Sos, banesa nr.1 Njësia Bashkiak nr.2 Tiranë.

## **Neni 14 Kompetencat e Adrninistratoreve**

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- ç) pergatisin dhe nenshkruejne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kornbetare te Biznesit;
- e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprirntarine e shoqerise tregtare;
- ë) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ns rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese ,apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore mete larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rczulton ne pasqyrat e fundit financiar te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligj it "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vernendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne rrejedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me per gjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per cdo veprirn ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtirn te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtirn me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe njedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane real izuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per administrimin ne kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e me poshtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) i shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyri met;
- d) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge llojore shlyerjen e plotë te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## Kreu IV

### Viti finanziar- Kalimi i fitimeve ne Kapitalin Themeltar ,ekspertet

#### Neni 16

##### Viti Financiar-kalimi i fitimeve ne kapitalin themeltare.

Viti finanziar i Shoqerise filion me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiare filion nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

1. Ortaket e shoqerise miratojne llogarite vjetore dhe evidentojne ekzistencen e fitimit
2. Ortaket e shoqerise percaktojne destinimin e fitimit pasi te jene zbritur:
  - a) rezerva ligjore,sipas ligjit ose te peraktuar nga ortaket.
  - b) fonde te tjera te nevojshme.
- 3.Ortaket percaktojne ndarjen e dividentit.
4. Me vendim te ortakeve te shoqerise, fitimet e pashperndara , te cilat nuk do te perdoren per te paguar shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise, do te kalojne ne Kapitalin Themeltar te shoqerise.

#### Neni 17

##### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrta e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## Kreu V

### Prishja -riorganizimi i shoqerise

#### Neni 18

##### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njofuar pezullimi i veprirntarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Biznesit";
- d) me vendirn te gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendirn me shkrirn ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper"

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### Neni 19 Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

#### Neni 20

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## Neni 21

### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretirnin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

### ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUA "EMERTIMI I SHOQERISE"

"NPA"shpk

Emër mbiemër nënshkrimi

1. Sotir Berhani 

2. Roni Guri 